



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 mars 2013
Nr. Ref.:RK396/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 20/13

Parashtruesi
Rifat Osmani

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme
Pkl. Nr. 10/2013, të datës 22 janar 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rifat Osmani (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" SHPK.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013, dorëzuar Parashtruesit të kërkesës më 20 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013.
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masën e përkohshme, gjegjësisht lirimimin e Parashtruesit të kërkesës nga paraburgimi.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe Rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 shkurt 2013, Parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.
7. Më 25 shkurt 2013, Kryetari emëroi Gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare Raportuese, si dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Surroy (anëtar) dhe Ivan Cukalovic (anëtar).
8. Më 26 shkurt 2013, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e Parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi kopjet e aktvendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta, të cilat janë përmendur nga Parashtruesi në kërkesën e tij. Në të njëjtën datë, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme që kërkesa është regjistruar me numrin KI 20/13.
9. Më 27 shkurt 2013, përfaqësuesi ligjor i Parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese aktvendimet e kërkuara për vazhdimin e paraburgimit, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, duke përfshirë këto vendime të Gjykatës Supreme: Pn. Nr. 228/2010 (7 maj 2010); Pn. Nr. 737/2010 (28 dhjetor 2010); Pn. Nr. 730/2011 (29 dhjetor 2011); Pn. Nr. 475/2012 (26 qershor 2012); Pn. Nr. 659/2012 (22 gusht 2012); si dhe Pn. Nr. 854/2012 (22 tetor 2012).

Faktet e rastit

10. Më 24 maj 2009, Policia e Kosovës bëri Kallëzimin Penal në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar që Parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë, në bazë të nenit 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës.
11. Në të njëjtën datë, gjyqtari i procedurës paraprake, me vendimin GJPP. Nr. 136/2009, të datës 24 maj 2009, caktoi paraburgimin ndaj Parashtruesit të kërkesës për një (1) muaj, përkatësisht deri më 22 qershor 2009.
12. Më 13 gusht 2009, Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009 për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar që Parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë, të përcaktuar me nenin 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës.
13. Më 5 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin e saj KA. Nr. 348/09 konfirmoi Aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009 kundër Parashtruesit të kërkesës, për veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë. Në aktvendimin e lartcekur, Gjyqtari kompetent për konfirmimin e Aktakuzës vendosi që Aktakuza ishte ushtruar në pajtim me ligjin, si dhe që vepra penale me të cilën ishte akuzuar Parashtruesi i kërkesës përmbante elementet e veprës penale të përcaktuar me nenin 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës, si dhe kishte theksuar që [...]”*nuk ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurëve, dhe që pengojnë ndjekjen penale të tyre.*”
14. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga Parashtruesi i kërkesës, në bazë të obligimit të gjykatës për të nxjerrë një aktvendim në lidhje me vazhdimin apo ndërprerjen e paraburgimit çdo dy muaj, nga qershori 2009 deri në shkurt të vitit 2013, tetëmbëdhjetë (18) aktvendime për vazhdimin e paraburgimit janë nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Aktvendimi i fundit, gjegjësisht Aktvendimi P. No. 383/09 për vazhdimin e paraburgimit është nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shkurt 2013. Për gjashtë (6) aktvendime të Gjykatës së Qarkut nga Parashtruesi i kërkesës është parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme ka konfirmuar pesë (5) nga këto aktvendime.
15. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara bashkë me kërkesën, gjegjësisht procesverbalet e seancave në Gjykatë, disa seanca janë mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ngjashëm, një numër dëshmitarësh, duke përfshirë edhe ekspertët, janë ftuar të paraqiten në Gjykatë. Megjithatë, dokumentacioni i dorëzuar nga Parashtruesi i kërkesës përmban referenca për procedurat e kësaj Gjykate vetëm për vitin 2011.

16. Kundër aktvendimeve të kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 383/2009, të datës 12 tetor 2012, si dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, Pn. Nr. 854/2012, të datës 22 tetor 2012, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, përfaqësuesit e Parashtruesit të kërkesës kanë dorëzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke propozuar që Gjykata Supreme [...]”*të ndryshojë aktvendimin e kundërshtuar, ashtu që të akuzuarit ti ndërpritet paraburgimi apo ti caktohet ndonjë masë alternative.*“
17. Më 22 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e saj Pkl. Nr. 10/2013 hodhi poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, duke theksuar që aktvendimet e kontestuara me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ishin më në fuqi, për arsyen që në bazë të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paraburgimi është zgjatur deri më 17 dhjetor 2012, derisa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pranuar më 18 janar 2013.
18. Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj gjithashtu thekson që [...]” *sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare për bazën ligjore për të cilën i është vazhduar paraburgimi, si dhe drejt ka vepruar kur të akuzuarit ia ka vazhduar paraburgimin sipas dispozitës së nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafët 1 dhe 2, pika (i) të KPPK, sepse, i akuzuari mund të iki apo arratiset nga përgjegjësia penale për shkak të peshës së veprës penale dhe dënimit eventual që do të mund t'i shqiptohet nëse shpallet fajtor, andaj me gjetjen e tij në liri ekziston rreziku se ai do të arratiset dhe do të pengojë sigurimin e prezencës së tij në procedurën e mëtejme penale*”.
19. Në të njëjtin aktgjykim Pkl. Nr. 10/2013, Gjykata Supreme thekson më tutje që [...]”*sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ia ka zgjatur vazhduar masën e paraburgimit, në përputhje me dispozitat e nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafët 1 dhe 2, pika (iii) e KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe nga mënyra tejet e vrazhdë - e ka pritur në veturë të akuzuarin tjetër i cili e ka vrarë mikun në oborrin e xhamisë, andaj gjakftohtësia e treguar nga ana e të akuzuarit duke e planifikuar dhe përgatitur kryerjen e veprës penale, janë fakte që tregojnë rrezikun se me lënien në liri i njëjti do të mund ta përsërisë apo të kryejë vepër penale të ngjashme*”.

Pretendimet e Parashtruesit

20. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës në veçanti konteston Aktgjykimin e fundit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013, në lidhje me refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e kontestuar në të gjitha pjesët e tij për shkak të jo-ligjshmërisë dhe mungesës së argumenteve.
21. Parashtruesi i kërkesës më tutje pohon që [...]”*Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme në Prishtinë, si autoritete publike, me mos-përfilljen dhe zvarritjen e procedurës hetimore dhe gjyqësore*“ kanë shkelur të drejtat e tij individuale të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenet 5.3 dhe 5.4 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e

të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe Protokollat e saj.

22. Parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, si dhe nenet 5.3 dhe 5.4 [E Drejta për Liri dhe Siguri] të KEDNJ-së dhe Protokollat e saj, janë cenuar si rezultat i jo-kushtetutshmërisë dhe jo-ligjshmërisë së zgjatjes së paraburgimit.
23. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata Kushtetuese të përcaktojë nëse *“është cenuar e drejta kushtetuese për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj si rezultat i dështimit të respektimit të neneve të sipër-përmendura.”*
24. Përveç kërkesave të lartpërmendura nga Parashtruesi, është parashtruar edhe kërkesa për vendosje të masës së përkohshme. Në kërkesën e tij për masë të përkohshme, Parashtruesi kërkon lirim të tij nga paraburgimi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

25. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e Parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.
26. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Në lidhje me kërkesën, Gjykata vëren që Parashtruesi i kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

27. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi i kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe nenin 47 (2) të Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, vendimi përfundimtar në rastin e Parashtruesit të kërkesës, është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013, i datës 22 janar 2013. Si rrjedhojë, Parashtruesi ka dëshmuar që ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi.

28. Parashtruesi gjithashtu duhet të dëshmojë se ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor. Nga shkresat e lëndës, mund të shihet që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 është dorëzuar tek Parashtruesit më 20 shkurt 2013, derisa Parashtruesi ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 22 shkurt 2013, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katërmujor, të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të Punës.
29. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh Rregullin 36 të Rregullores së Punës, i cili përcakton që:
- “(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*
30. Në rastin konkret, sa i përket procedurave në gjykatat e rregullta, Gjykata i referohet Konfirmimit të Aktakuzës, të datës 5 tetor 2009, si dhe aktvendimeve të nxjerra nga Gjykata e Qarkut që prej vitit 2009, duke përfshirë aktvendimin e fundit të Gjykatës Themelore të datës 13 shkurt 2013 për vazhdimin e paraburgimit. Në të gjitha vendimet e saj për vazhdimin e paraburgimit, Gjykata e Qarkut ka vlerësuar që në bazë të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si dhe peshën e veprës penale, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit. Ky arsyetim është konfirmuar nga Gjykata Supreme në aktvendimet e saj, me të cilët ka hedhur poshtë ankesat e Parashtruesit si të pabazuara.
31. Gjykata më tutje vëren që Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin e saj Pkl. Nr. 10/2013 ka hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, duke konfirmuar kështu që gjykata e shkallës së parë ka ofruar arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare mbi bazën ligjore të vazhdimin të paraburgimit, si dhe që ka vepruar drejt kur ka vazhduar paraburgimin e Parashtruesit të kërkesës.
32. Në këtë kontekst, u mbetet gjykatave të përcaktojnë nëse, në bazë të rrethanave të rastit, kohëzgjatja e paraburgimit ka tejkaluar kufirin e arsyeshëm. Me fjalë tjera, gjykatat kanë diskrecion të vendosin se çfarë është e arsyeshme në rrethanat e caktuara (Shih, *mutatis mutandis Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, 7 GJEDNJ (ser. A) tek 23, 1968). Në kërkesën konkrete, arsyetimet e prokurorisë dhe gjykatave për vazhdimin e paraburgimit i referohen peshës së veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës, gjakftohtësisë së të akuzuarit, si dhe kështu, edhe rrezikut të ikjes apo përsëritjes së veprës, apo kryerjes së ndonjë vepre të ngjashme. Këto rrethana duken që i atribuohen ndërlikueshmërisë së rastit, duke i pamundësuar kësaj Gjykate të vlerësojë që kohëzgjatja e procedurave është e paarsyeshme (Shih *mutatis mutandis, Boddaert kundër Belgjikës*, Ap. Nr. 12919/87, miratuar më 12 tetor 1992).

33. Për më tepër, sa i përket veprimeve të prokurorisë dhe gjykatës së shkallës së parë, nuk ka prova të tilla që paraburgimi është vazhduar pa arsye, apo që gjykata ka qenë plotësisht pasive apo pasive për një periudhë të gjatë kohore (Shih *mutatis mutandis*, *Arsov kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Ap. Nr. 44208/02, miratuar më 19 tetor 2006).
34. Gjithsesi, Gjykata vetëm se mund të marrë parasysh nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrën që t'i sigurohet Parashtruesit gjykimi i drejtë (Shih, mes burimeve tjera, *Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
35. Më tej, Gjykata rithekson që Gjykata Supreme e Kosovës, si dhe gjykatat tjera të rregullta, janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor.
36. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e prezantuara nga Parashtruesi i kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, si dhe që Parashtruesi nuk ka dëshmuar që të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Kërkesa për masë të përkohshme

37. Neni 27 i Ligjit, dhenë veçanti Rregulli 54 (1) i Rregullores së Punës, përcaktojnë që *“në çfarëdo kohe përdërisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.”*
38. Megjithatë, duke marrë parasysh që Kërkesa është shpallur e papranueshme, Parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës, që të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.
39. Për më tepër, Gjykata vëren që Parashtruesi nuk ka dëshmuar se si interesat e tij do të vuanin dëme të pariparueshme nëse masa e përkohshme nuk vendoset. Në fakt, sa i përket kërkesës së Parashtruesit për lirim nga paraburgimi, kjo Gjykatë nuk e konsideron si kompetencë të vetën që t'i ofrojë këtë mbrojtje Parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullat 36, 54, 55 dhe 56 të Rregullores së Punës, më 12 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani